

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	7 dhjetor 2018
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	06.03.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 06.03.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MD dhe MIE- 01
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Emri, Mbiemri, <i>e-mail</i> -i dhe numri i telefonit:

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Veprimtaritë mediatike që ofrohen përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike vecanërisht internetit (online) janë një fenomen në rritje në ditët e sotme. Zhvillimi i vrullshëm i shërbimeve të ofruara përmes internetit po ndryshon thellësisht mënyrën e marrjes së informacionit. Po ashtu, aksesit i çdo individi dhe përdorimi i portaleve online nga një numër i pakufizuar personash rrit shkallën e ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit. Ky fluks i madh informacioni ngre shqetësim për përhapjen në kohë reale të lajmeve të rreme në epokën digjitale dhe ndikimi negativ që ka dezinformimi tek besueshmëria dhe pavarësia e gazetarisë profesionale tek vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut, është problematikë që kërkon ndërhyrje legjislative. Për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, ekonomik dhe kulturor, në shoqërinë shqiptare.

Si rrjedhojë lind nevoja e ndërhyrjes së qeverisë për të rregulluar veprimtarinë e një kategorie ofruesish të përmbajtjeve mediatike që përdorin internetin si mjet për zhvillim aktiviteti me qëllim mbrojtjen e individëve prej dezinformimit, rritjen e cilësisë profesionale të gazetarisë, Po ashtu kjo ndërhyrje justifikohet edhe me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të miturve prej përmbajtjeve të papërshtatshme.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Të normohet veprimtaria e shërbimeve të publikimeve elektronike;
- Të garantohet e drejta e informimit dhe lirisë së shprehjes;
- Të mbrohet dinjteti dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

- Të respektohet dhe garantohet e drejta e ruajtjes së jetës private,
- Të moslejohen publikimet që nxisin dhunën, gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme, etj,
- Të respektohet dhe mbrohet e drejta e autorit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: Status Quo-ja (ska rregullim ligjor);

Opsioni 1 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Opsioni 2: Miratimi i një ligji të ri vetëm për median online.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar nuk shoqërohet me ndikim ekonomik për Buxhetin e Shtetit, pasi AMA është organ publik i pavarur që nuk financohet nga Buxheti i Shtetit.

Propozimi i politikave do të sjellë kosto të drejtpërdrejta për subjektet (OSHPE) që do të përfshihen në fushën e zbatimit të opsionit të preferuar, si rezultat i kërkesës për të punësuar një ose disa persona përgjegjës të publikimeve elektronike. Përfitimi kryesor i drejtpërdrejtë ekonomik që pritët të vijë si rezultat i kësaj politike do të jetë ulja e nivelit të informalitetit lidhur me deklarimin e punëmarrësve, deklarimin dhe pagesën në organet tatimore për përgjegjësitë tatimore për shërbimet që ofrojnë (sic janë reklamat në portale), rritje të të ardhurave tatimore dhe reduktim të pagesave të papunësisë teksa individët punësohen. Një tjetër përfitim i pritshëm mund të jetë shkëmbimi i pagesave në kuadër të mbrojtjes së të drejtës së autorit.

Propozimi pritët të sjellë sidomos **ndikime sociale**: - rregullimi i peizazhit mediatik, rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit lidhur me kontentin e publikuar, ndikime pozitive në komunitetin e gjerë nëpërmjet nxitjes së punësimit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është Opsioni 1, pasi në kushtet aktuale të tregut, në qoftë se nuk miratojmë ndryshime ligjore për të normuar veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve elektronike, të cilët ofrojnë përmbajtje në mënyrë ditore ose periodike dhe që synojnë informimin, argetimin dhe edukimin e publikut, tregu do të mbetet pa rregullim ligjor.

Ndryshimi i ligjit në fuqi që rregullon veprimtarinë e subjekteve audio/audioviziv është masë efektive pasi po të njëjat parime do të shtrihen edhe për OSHPE-të.

Vlera monetare e koston dhe e përfitimeve nga ndikimet e mundshme nuk mund të përcaktohet për shkak të të dhënave dhe informacionit të kufizuar. Sidoqoftë, ato janë vlerësuar në aspektin cilësor, aty ku ka qenë e mundur.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Jo e aplikueshme	Jo e aplikueshme	Jo e aplikueshme
KONSULTIMI <i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)</i> Në periudhën dhjetor 2018 – janar 2019, janë zhvilluar 4 tryeza konsultimi publik, me pjesëmarrjen e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, përfaqësues të mediave elektronike, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare si dhe të shoqatave që në fokus të punës së tyre kanë median por edhe të drejtat e njeriut. Gjithashtu projektligji është publikuar më datë 07.12.2018 në Regjistrin e Konsultimit Publik për tu konsultuar me palët e interesit.		
ZBATIMI DHE MONITORIMI <i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?</i> Autoriteti i ngarkuar për zbatimin e detyrimeve sipas këtij ligji do të jetë Autoriteti i Mediave Audiovizive si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të mediave elektronike. Për ekzekutimin e vendimeve në zbatim të opsionit të preferuar, është ngarkuar Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.		

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- Jepni kontekstin e politikës

Kuadri ligjor ekzistues që rregullon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre është ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Në momentin e miratimit të ligjit për mediat audiovizive në vitin 2013, roli i teknologjisë dhe internetit në përhapjen e informacionit nuk ishte në dimensionet që ka arritur sot informimi nëpërmjet portaleve online.

Kuadri ekzistues në fuqi nuk parashikon asnjë rregullim për veprimtarinë e kësaj kategorie subjektsh.

Në këto kushte, duke mbajtur në fokus veçanërisht influencën e portaleve online gjatë viteve të fundit është e nevojshme që të ndërmerret një nismë ligjore me qëllim që zhvillimet teknologjike sociale etj, të ecin paralelisht me evoluimin e kuadrit ligjor.

Problemi në shqyrtim

- Përshkruani natyrën e problemit.
- Identifikoni shkaqet e problemit.
- Përshkruani shtrirjen e problemit.
- Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.
- Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

Natyra e problemit

- 1) Veprimtaria e ushtruar prej mediave online përbën shqetësim për përhapjen në kohë reale të lajmeve të rreme, mund të cenojë pavarësinë e gazetarisë profesionale si dhe saktësinë

dhe verifikimin e informacionit. Praktika e publikimit të deklaratave dhe informacionit sjell një situatë që gazetarët e marrin lajmin pa e verifikuar (facebook, të titter apo edhe ëb faqe);

- 2) Bërja e lajmit sensacional duke i vendosur tituj bombastik dhe që synojnë të tërheqin vëmendjen e lexuesve në mënyrë që të marrin sa më shumë klikime në portal;
- 3) Përmeshja e kërkesave të tjera, të cilat do të ishin normale në funksionimin e ndërmarrjeve të mediave, siç janë deklarimi i të ardhurave, burimet e financimit, lista e të punësuarve dhe pagesa e kontributeve shoqërore, pagimi i taksave etj, nuk janë aspak të identifikueshme në peizazhin aktual të mediave online. Në këtë drejtim, mund të thuhet se peizazhi i mediave online duket se është krejtësisht i parregulluar.

Shkaqet e problemit

Disa nga shkaqet e tendencave të mësipërme mund të jenë pasojë e arsimimit dhe formimit profesional të dobët.

- Synimi i rritjes së numrit të klikimeve për efekte financiare (rritjen e kërkesave për kohë reklame);
- Mungesë e kualifikimeve të stafit të punësuar pranë portaleve;
- Mungesa e një autoriteti që garanton të drejtat dhe liritë e individëve që mund të preken nga publikimet e rreme, të pasakta, etj;
- Mungesa e përgjegjësisë administrative në rast shkeljesh administrative.

Shërbimi i ofruar përmes portaleve online i drejtohet një numri të pakufizuar ndjekësish/lexuesish në dallim nga shërbimi i ofruar përmes tv/audio që kanë zonë fikse shërbimi.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Rregullimi i veprimtarisë së portaleve online përmes një kornize ligjore ka si qëllim arritjen e një ekuilibri ndërmjet qasjes në shërbimet e përmbajtjes online, mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencës, garantimin e të drejtave të njeriut, respektimin e të drejtave të autorit për sa kohë këto shërbime përdorin vepra që i nënshtrohen të drejtës së autorit, si dhe arritjen e një gazetarie profesionale, të lirë dhe të pavarur.

Të drejtat e njeriut nuk e përjashtojnë ndalimin dhe ndëshkimin e shpifjes, edhe për sa i përket fushës së internetit. Liria e shprehjes së individit zbatohet edhe në internet, sikundër është e zbatueshme në çdo lloj mjeti tjetër të komunikimit.

Kufizimet janë të lejueshme vetëm nëse kalojnë testin e tre pjesëve legalitetin, legjitimitetin dhe proporcionalitetin. Ndërhyrjet në lirinë e shprehjes janë legjitime nëse: a) parashikohen me ligj, b) ndjekin qëllim të ligjshëm; c) janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja e ndërhyrjes së qeverisë vjen për arsye të rregullimit me ligj të veprimtarisë së një kategorie ofruesish të përmbajtjes mediatike që përdorin internetin si mjet për zhvillim aktiviteti dhe që synon mbrojtjen e individëve prej dezinformimit, rritjen e cilësisë

profesionale të gazetarisë, Po ashtu kjo ndërhyrje justifikohet edhe me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të miturve prej përmbajtjeve të papërshtatshme.

Projektligji është hartuar nga grupi i punës, i cili kishte në përbërjen e tij përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe ekspertë të fushës dhe do të paraqitet pranë Këshillit të Ministrave, si bashkëpropozim i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

1. Të normohet veprimtaria e shërbimeve të publikimeve elektronike.

Qëllimi kryesor i kësaj politike është të rregullojë veprimtarinë e shërbimeve të publikimeve elektronike, ku përfshihen programe/publikime, përmbajtja e të cilave, transmetohet/publikohet nëpërmjet internetit, dhe ka si qëllim informimin, argëtimin dhe edukimin e publikut.

2. Të garantohet e drejta e informimit dhe e lirisë së shprehjes.

E drejta e informimit dhe liria e shprehjes përbëjnë të drejta themelore të njeriut, mbrojtja e të cilave garantohet prej konventave ndërkombëtare si dhe legjislacionit tonë të brendshëm. Liria e shprehjes nuk është absolute, ajo hyn në kategorinë e të drejtave që shoqërohen me detyrime dhe përgjegjësi, pasi çdo individ që shprehet publikisht, si në median online dhe atë audiovizive duhet të jetë i përgjegjshëm dhe për atë që shkruan dhe publikon.

3. Të mbrohet dinjiteti dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Ndërhyrja nëpërmjet kësaj politike ka si qëllim përmbushjen e interesit publik për promovimin e respektimit të dinjitetit, të të drejtave dhe lirive themelore, respektimit të privacisë, e reputacionit.

4. Të respektohet dhe garantohet e drejta e ruajtjes së jetës private.

Përdorimi në masë i rrjeteve të komunikimit elektronik sidomos internetit ka zgjeruar së tepërmi shpërndarjen dhe kanalet e komunikimit. Kjo lloj teknologjie ka ngritur problematikën e përmbajtjes së lajmeve të krijuara nga përdoruesit dhe gazetarisë së hapur. Përdoruesit përmes kësaj teknologjie mund të bashkëveprojnë me mediat e ndryshme, etj.

5. Të mos lejohen publikimet që nxisin dhunën, gjuha e urrejtjes, lajmet e rreme.

Aksesi i lehtë në bërjen e lajmit, pasohet shpeshherë me publikimin e lajmeve të njëanshem të pavërteta dhe të pabesueshme, të cilat përhapen brenda fare pak minutash Po ashtu, gjuha e urrejtjes (hate speech) po kthehet pjesë përbërëse e diskursit publik. Nisma synon mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i papërshtatshëm dhe i dëmshëm i përmbajtjeve në mediat online.

6. Të respektohet dhe mbrohet e drejta e autorit.

Produktet që publikohen prej ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike mund të jenë objekt i së drejtës së autorit, prandaj parashikohet si detyrim që subjektet duhet të respektojnë

të drejtat e autorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0: Status Quo-ja (ska rregullim ligjor)

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar rregullon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse. Fusha e zbatimit të tij përfshin transmetimet lineare dhe ato jo lineare në përputhje me Direktivën e Shërbimeve Mediatike Audiovizuale dhe në frymën e direktivave të rrjeteve të komunikimeve elektronike, shërbimet e reja të programeve si dhe shërbimet e mbrojtura.

Megjithatë, shërbimet që ofrohen prej mediave online janë jashtë fushës së veprimit të këtij ligji.

Opsioni 1 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Në ligjin në fuqi parashikohen parimet themelore të veprimtarisë së subjekteve audio/audiovizive: *“veprimtaria e transmetimeve audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit;”* Ligji në fuqi parashikon gjithashtu që programet radiotelevizive publike dhe private respektojnë dinjitetin vetjak dhe të drejtat themelore të njeriut, paanshmërinë, plotësinë dhe pluralizmin e informacionit, të drejtat e fëmijëve dhe të adoleshentëve, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese të shtetasve, të pakicave kombëtare në përputhje me konventat ndërkombëtare si dhe diversitetin fetar shqiptar. Duke qenë se edhe veprimtaria e Ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike duhet të respektojë parimet e mësipërme, vlerësohet si më e përshtatshme ndërhyrja në ligjin nr. 97/2013 “2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Po ashtu, struktura që do të shqyrtojë ankesat që do të paraqiten për shkeljet administrative të pretenduara, është strukturë ekzistuese, dhe me ndryshimin e propozuar do t’i zgjerohet fusha e kompetencës.

Ndryshimi i propozuar i ligjit do të zgjerojë objektin dhe duke shtuar në fushën e zbatimit të tij edhe shërbimet e publikimeve elektronike. Ndryshimet bëhen me qëllim që shërbimet e publikimeve elektronike gjatë veprimtarisë së tyre të respektojnë të njëjtat parime të sanksionuara në këtë ligj për shërbimet audiovizive. Po ashtu në projekt, parashikohet se të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingo televizive janë të ndaluara.

Opsioni 2: Miratimi i një ligji të ri vetëm për mediat online.

Miratimi i një ligji të posaçëm për median online, nuk vlerësohet i përshtatshëm pasi ka një kuadër rregullator ekzistues. Mbajtur parasysh se ofruesit e shërbimeve të publikimeve

elektronike ngarkohen me detyrime të cilat i mbartin edhe subjektet audio/audiovizivë në veprimtarinë e tyre, përfshirja e tyre në fokusin e ligjit për mediat audiovizive është më efikas.

Po ashtu, kundërvajtjet administrative për të cilat parashikohen edhe sanksionet përkatëse, struktura e zbatimit të ligjit është ekzistuese. Nëse do të miratohej një ligj i posaçëm për këtë lloj shërbimi do të gjendeshim në rregullime ligjore paralele për të njëjtat problematika.

Një ndryshim i ri do të pasohej edhe me efekte financiare pasi, do të kërkonte krijimin e strukturave të reja për vënien në zbatim të ligjit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përkrahuesi nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përkrahuesi nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Palët e prekura prej opsionit të preferuar, janë:

a) Ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike, çdo individ si dhe AMA.

Opsioni i preferuar nuk shoqërohet me kosto për buxhetin e shtetit, pasi AMA është organ publik i pavarur që nuk financohet nga buxheti i shtetit.

Propozimi i politikave do të sjellë ndikim të drejtpërdrejta për subjektet (OSHPE) të karakterit financiar, si rezultat i kërkesës për të punësuar një ose disa persona përgjegjës të publikimeve elektronike.

Projekti ka gjasa të shoqërohet me efekte financiare edhe në buxhetin e shtetit, pasi për kundërvajtjet administrative parashikohen masa administrative gjobë, të cilat janë tituj ekzekutivë, 80% e masës së të cilave derdhet në buxhetin e shtetit.

Megjithatë, ndikimi financiar që do të kenë këto sanksione, është i pamundur të matet pasi nuk mund të parashikohet numri i shkeljeve dhe frekuenca si dhe nuk ka një ekperiencë të mëparshme që na lejon të 'vlerësojmë' këtë impakt.

Përfitimi kryesor i drejtpërdrejtë ekonomik që pritet të vijë si rezultat i kësaj politike do të jetë ulja e nivelit të informalitetit lidhur me deklarimin e punëmarrësve, deklarimin dhe pagesën në organet tatimore për përgjegjësitë tatimore për shërbimet që ofrojnë (siç janë reklamat në portale), rritje të të ardhurave tatimore dhe reduktim të pagesave të papunësisë teksa individët punësohen. Një tjetër përfitim i pritshëm mund të jetë shkëmbimi i pagesave në kuadër të mbrojtjes së të drejtës së autorit.

Masat plotësuese ndëshkuese ndaj OSHPE-ve pritet të kenë ndikim në veprimtarinë tregtare të tyre përse do të pezullohet/ndërpritet fillimisht 24 orë/7 ditë e më tej 1 vit, veprimtaria e OSHPE-ve. Këto masa mund të kenë pasojë për OSHPE-të, për shkak të marrëdhënieve kontraktore që këto subjekte mund të kenë më palë të treta (reklamimi/marrëdhënie punësimi/kontrata shërbimi).

b) Ndikimi në AMA

AMA është institucion i pavarur që financohet nga burimet e veta dhe nuk përfiton fonde nga buxheti i shtetit ndaj dhe propozimet për shtesa në strukturë dhe organikën e tij nuk kanë efekte financiare në ligjin e buxhetit të shtetit, por efektet financiare i merr përsipër t'i mbulojë nga të ardhurat e veta. AMA paraqet pranë Kuvendit të Shqipërisë kërkesën për ndryshime në strukturën dhe organikën e institucionit të tij. Kërkesa e AMA-s drejtuar Komisionit parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (KEMIP) shoqërohet edhe me vendimin e Këshillit të AMA-s si organi kolegjal kompetent për vendimmarrjen përkatëse lidhur me propozimin e ndryshimeve strukturore.

Kjo kërkesë vjen në mbështetje të nenit 15 pika 2 dhe nenit 19 pika 17 e ligjit 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, të cilat përcaktojnë kompetencën ligjore të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e propozimeve për strukturën organizative të institucionit të AMA-s. KEMIP për të vlerësuar dhe më tej miratuar propozimet e AMA-s lidhur me ndryshimet strukturore, duhet të marrë mendimin e detyrueshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe DAP.

Këto ndryshime strukturore, kanë si qëllim pasjen e një strukture eficiente dhe me fleksibilitet më të madh për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet dhe çështjet që po hasen si pasojë e zhvillimeve dhe proceseve teknologjike në fushën e medias, duke iu përshtatur nevojave që kërkon realizimi i detyrimeve funksionale.

c) Ndikime në komunitet

Propozimi pritet të sjellë sidomos **ndikime sociale**: - rregullimi i peizazhit mediatik, rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit lidhur me kontentin e publikuar, ndikime pozitive në komunitetin e gjerë nëpërmjet nxitjes së punësimit.

Mediat luajnë rol etik në gjenerimin e kulturës demokratike, dhe propozimet ligjore kanë si qëllim që t'i ofrojnë publikut një përmbajtje sa më cilësore.

Përfitim të drejtpërdrejtë social pritet të ketë parashikimi ligjor për ndalimin e reklamave për lojrat e fatit, ndryshimi ligjor synon mbrojtjen e interesit shoqëror, duke hequr çdo mundësi për promovimin e lojrave të basteve në median online. Kjo lloj iniciative ekonomike e personave juridikë dhe fizikë bie ndesh me interesin shoqëror dhe nuk ofron asnjë vlerë të karakterit social, përkundrazi ka pasoja sociale negative në shoqëri.

Komunikimet me natyrë tregtare duhet të parandalojnë shkaktimin e dëmeve morale dhe fizike për të miturit, si dhe të mos i ekspozojnë ata në mënyrë abuzive në situata të rrezikshme për ta.

Ndalimi kategorik i këtyre reklamave në mënyrë të shprehur do të ndikojë pozitivisht në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe do t'i shërbejë parandalimit të përfshirjes në lojërat e fatit të moshave të reja dhe luftës ndaj varësisë nga to, të cilat konsiderohen si qëllime të rëndësishme për të mirën e përbashkët, duke qenë se të tilla vese sjellin pasoja të rënda jo vetëm për vetë personin, por edhe për familjen e tij dhe shoqërinë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 1, ndryshimi i ligjit ekzistues në të cilin parashikohen normat bazë dhe parimet e ushtrimit të aktivitetit të OSHPE-ve. Po ashtu, është në funksion struktura e ngarkuar për monitorimin e respektimit të të drejtave themelore të njeriut nga transmetimet audiovizive.

Në ligjin në fuqi jepet përkufizimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike që janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë internetin, rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kablllove elektrike në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet audiovizive dhe rrjetet kablllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.

Pra pavarësisht mjetit që përdoret për përcjelljen e sinjalit, rregullat e zbatueshme për ofruesit e shërbimit duhet të jenë të njëjta. Rregullat dhe parimet që respektojnë përmbajtjen e ofruar prej subjekteve mediatike duhet të jenë të njëjta me përmbajtjen e ofruar prej ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike.

Aktualisht veprimtaria e tyre nuk rregullohet me asnjë akt, ndërkohë që palët e dëmtuara mund të kërkojnë vetëm gjyqësisht zgjidhjen e konfliktit, ndërkohë që lajmi/publikimi i rremë apo i pavërtetë ka ecur dhe e ka sjellë efektin negativ pra e ka shkaktuar dëmin.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Struktura e ngarkuar për zbatimin e opsionit të preferuar është Autoriteti i Mediave Audiovizive. Projekti parashikon strukturat përkatëse, procedurat dhe afatet për trajtimin e

ankesave dhe të drejtën e përgjigjes duke ia ngarkuar këtë kompetencë Këshillit të Ankesave. Duke patur parasysh natyrën e shërbimit, afatet për paraqitjen e ankesave dhe shqyrtimin e tyre janë më të shkurtra se në mediat audiovizive, për t'a bërë sa më efektiv zbatimin e ligjit.

Këshilli i Ankesave, strukturë aktuale pranë AMA-s, ka si objekt të punës mbikëqyrjen e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, etj, si dhe shqyrtimin e ankesave për përmbajtjen e programeve dhe të drejtën e përgjigjes.

Rregullatori për efekt të shqyrtimit dhe marrjes së masave ndaj kësaj kategorie ofruesish kontenti, bashkëpunon me autoritetet e tjera publike, si AKEP, organi i cili:

- 1- Do të administrojë regjistrin e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike me domain.al dhe do të ekzekutojë vendimmarrjet e AMA-s.
- 2- Do të ekzekutojë vendimmarrjet e KA-së për bllokim aksesit të shërbimit, për OSHPE-të që nuk janë në regjistrat e domain-eve të administruar nga AKEP.

Si pengesë e mundshme për zbatimin e ligjit mund të jenë afatet e shkurtra të propozuara për marrjen në shqyrtim të ankesave nga Këshilli i Ankesave, AMA dhe AKEP.

Një tjetër pengesë mund të jetë edhe përcaktimi i formës dhe mënyrës së komunikimit midis organeve publike apo edhe marrja e masave për OSHPE-të që ushtrojnë aktivitet nga jashtë territorit të vendit.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Projektligji parashikon që çdo person, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta ka të drejtën e përgjigjes si dhe që OSHPE-të kanë detyrim të marrin në shqyrtim ankesat e paraqitura për përmbajtjet e publikuara të pavërteta, të paanshme, etj. AMA nuk do të monitorojë veprimtarinë e OSHPE-ve por do të vihet në lëvizje mbi bazën e ankesave për përmbajtjet e publikuara apo ushtrimin e të drejtës së përgjigjes.

Numri i ankesave të marra për trajtim do të jetë edhe treguesi për efektivitetin e parashikimeve të normave të reja ligjore.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës											
Kosto për buxhetin – një herë											
Kosto për buxhetin – në vazhdim											
Kosto për biznesin – një herë											

Kosto për biznesin – në vazhdim											
Kosto për grupet e tjera – një herë											
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim											
Kosto në total											
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës											
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim											
Përfitimi për biznesin – një herë											
Përfitimi për biznesin – në vazhdim											
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë											
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim											
Kosto për buxhetin – në vazhdim											
Përfitimi në total											
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës											
Vlera aktuale e kostos në total											
Vlera aktuale e përfitimit në total											
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total											

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			